




Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Južna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

DREJTORIA PËR BUJQËSI DHE ZHVILLIM RURAL



NJOFTIM

THIRRJE PËR APLIKIM TË FERMERËVE (Pagesa Direkte për qumësht)

Komuna e Mitrovicës së Jugut, përkatësisht Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, bazuar në Rregulloren Komunale me Nr. Prot.02-060/01-0039654-3/23, dt. 31.05.2023 për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve dhe Granteve, ka marrë vendim për përkrahjen e sektorit të blegtorisë, duke i subvencionuar fermerët - prodhuesit e qumështit për litër. Vlerat e subvencionimit do të jetë 0.10 € për litër.

I. Kriteret që duhet t'i plotësojnë fermerët/aplikuesit:

- Të jenë banorë të komunës së Mitrovicës së Jugut dhe aktivitetin e tyre prodhues ta realizojnë brenda territorit të Komunës së Mitrovicës së Jugut;
- Të ofrojnë dëshmi të lëshuar nga laboratorit i AUV-së për cilësinë e qumështit, të dorëzuar në qumështore të licencuara ose në ndonjërin nga pikat e grumbullimit të qumështit si biznese, të cilat kanë kontratë me ndonjërin qumështore të licencuara;
- Të kenë kontratë të vërtetuar nga noteri, për shitjen e qumështit në ndonjërin nga qumështoret e licencuara ose në ndonjërin nga pikat e grumbullimit të qumështit si biznese, të cilat kanë kontratë me ndonjërin qumështore të licencuar;
- Të ofrojnë dëshmi bankare për sasinë mujore të qumështit të shitur;
- Të kenë dorëzuar së paku 2,000 (dy mijë) litra qumësht dhe më së shumti deri në 30,000 (tridhjetë mijë) litra qumësht për 6 (gjashtë) muaj;
- Subvencionimi do të bëhet për litër qumësht të dorëzuar, brenda kornizave prej më së paku 2,000 deri 30,000 litra.

II. Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim:

- Kërkesën e plotësuar për aplikim;
- Kopjen e letërnjoftimit të Republikës së Kosovës;
- Certifikatën e regjistrimit nga regjistri i fermës si fermerë (NIF);
- Konfirmimin nga banka për xhirollogarinë bankare;
- Kopjen e listës së verifikimit të kafshëve: gjedhet, dhentë dhe dhitë, të lëshuar nga Sektori për identifikim dhe regjistrim në kuadër të AUV-së;
- Kopja e kontratës, e vërtetuar nga noteri, për furnizim me qumësht, të lëshuar nga qumështoret e licencuara ose në ndonjërin nga pikat e grumbullimit të qumështit si biznese, të cilat kanë kontratë me ndonjërin qumështore të licencuar;
- Dëshmia për sasinë e qumështit të dorëzuar në qumështore ose pikën grumbulluese të qumështit;
- Dëshmia nga banka për sasinë e qumështit të shitur;
- Dëshmia për pjesëmarrjen në projektin "Transparenca dhe neutraliteti i marrjes së mostrave të qumështit".



III. Nëse aplikuesi është biznes i regjistruar, ai duhet të dorëzoj edhe:

- Kopjen e letërnjoftimit të Republikës së Kosovës të aplikuesit/pronarit të biznesit;
- Kopja e certifikatës së regjistrimit të biznesit - ARBK;
- Dëshmia për obligimet e kryera ndaj ATK-së;
- Konfirmimi nga banka për xhirollogarinë bankare të aplikuesit /pronarit të biznesit.

Thirrja Publike qëndron e publikuar 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga data e shpalljes.

Marrja e aplikacioneve dhe dorëzimi i dokumenteve bëhet në Zyrën pritëse në Komunën e Mitrovicës së Jugut, nga ora 9.00-15.00.

Vëmendje: Kërkesat të cilat nuk kompletohen, dhe në mungesë të dokumentacionit, të njëjtat do të refuzohen nga Komisioni.



Repzije Tmava-Tupella

Drejtore për Bujqësi dhe Zhvillim Rural

